



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:157586

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492489

C.nr.2023:157587

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore të iniciuar me padi nga ana e paditësit I.I. me vendbanim në fshatin.... Komuna Shtime, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit , me objekt kontesti kompensimin e pagave përcjellëse, vlera e kontestit 396.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 22 mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit I. I. me të cilën ka kërkuar që të “Detyrohet e paditura Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të shujtve ditore per vitin shkollor 2022/2023, t’ia paguaj shumën prej 396.00 € (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro), me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur që nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në përmbushjen definitive të obligimit si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi” si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi I. I. përmes të autorizuarit të tij , pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 20.07.2023, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore për vitin shkollor 2022/2023, kundër të paditurës Komuna Shtime Drejtoria e Arsimit, vlera e kontestit 396.00 euro .

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në pozitën e punës si punëtor teknik dhe se i njëjti nuk është kompensuar për shujtat ditore ,andaj duke u bazuar në kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë në nenin 35 par 7 me të cilën parashihet kompensimi për shujtën ditore por e njëjta nuk është paguar , andaj paditësi është detyruar të parashtoj padi.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse duke theksuar se paditësja nuk e ka provuar me asnjë provë se nuk e ka realizuar këtë të drejtë . Si dhe ka theksuar se MASHT me datë 21.11.2022 ka bërë shkëputjen e kësaj kontrate dhe rrjedhimisht e njëjta kontratë nuk prodhon detyrim. Andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjithashtu e paditura në përgjigje në padi është thirrur me njoftimin e MASHTI me numër 01B/488 të datës 21.11.2022 me të cilin njoftim ka bërë shkëputjen e kontratës kolektive të datës 22.01.2022, dhe nga kjo rezulton fakti se kontrata kolektive e datës 22.01.2021 nuk prodhon efekte juridike. Andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie punë tek e paditura .

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e shujtave.

Nga vërtetimi për përvojën e punës i datës 21.07.2021 me numër protokoli 07/88 të lëshuar nga institucioni gjegjesisht shkolla ku paditësi punon gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në vitin shkollor 2022/2023 ka ditë pune efektive 198 ditë.

Me kontratën për ekzistimin e marrëdhënies së punës është vërtetuar fakti paditësi që nga data 01.09.2022 e ka themeluar marrëdhënjen e punës për kohë të pacaktuar .

E paditura në përgjigje në padi, është thirrur në faktin se kontrata kolektive e arsimit, mbi të cilën paditësi kërkon kompensimin e shujtave, nuk është në fuqi dhe rrjedhimisht paditësit nuk i takon kjo e drejtë. Bazuar në këtë pretendim gjykata ka analizuar shkresat e lëndës dhe ka gjetur se;

Me nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës 03/L-212, i cili është në fuqi parashihet se: *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Po ashtu me nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet; 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive; 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar lidhur me kompensimin e shujtave ne vlere prej 396.00 euro per 198 ditë pune dhe atë duke u bazuar në vetë kërkesën e palës paditëse, pasi që i njëjti ka kërkuar që të bëhet kompensimi i shujtave në kuptim të nenit 35. Paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e cila ka hyrë në fuqi 22.01.2021.

Gjykata ka analizuar dispozitën e lartë cekur, mirëpo ka gjetur se sipas njoftimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01B/488 të datës 21.11.2022 është bërë shkëputja e kësaj Kontrate Kolektive, cka lenë të kuptohet se kjo kontratë nuk është në fuqi dhe nuk gjen zbatim në praktik për periudhën apo nuk përfshin të drejtat dhe detyrimet që lindin pas shkëputjes së të njëjtës.

Përkritazi me këtë, Gjykata ka marr për bazë edhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 214/2023 i datës 09.10.2023, pika III e këtij mendimi, ka përcaktuar se *“Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizata e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet për periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022”*. Andaj, në bazë të kësaj, gjykata konstaton se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021 nuk ka zbatueshmëri në këtë çështje juridiko kontestimore pasi që paditësit moshën e pensionimit e ka arritur në kohën kur kjo kontratë kolektive nuk gjene zbatim sepse padia eshte parashtruar me datë 20.07.2023 dhe rrjedhimisht

lenë të kuptohet kërkesëpadia e paditësit edhe duhet të refuzohet si e pabazuar në mungesë të bazës ligjore.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje, përtej asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin në pikën II të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka specifikuar ato.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2023:157587, me datë 22 mars 2024

Gjyqtarja
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.